



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA E PËRGJITHSHME

MINISTRIA E BRENDSHME

Nr. 1079 Prot. Datë 15.07.2020

Nr. 5270 Prot. Datë 16.07.2020

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

Nr. 74124 Prot. Datë 27.7.2020

MEMORANDUM BASHKËPUNIMI

“Për rritjen e efektivitetit në hetimet që lidhen me pastrimin e parave, financimin e terrorizmit, krimet financiare dhe sekuestrimin e konfiskimin e aseteve kriminale, në funksion të përbushjes së rekomandimeve të KSA¹-së e FATF dhe Planit të Veprimit² ICRG/FATF”

TË VETËDIJSHËM:

Për nevojën dhe rëndësinë e bashkëpunimit të gjërë në hetimet që lidhen me të gjitha format e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale penale ose i veprimtarisë kriminale;

NISUR NGA FAKTI:

Se Grupi i Posacëm i Veprimit Financiar (FATF) ³ ka listuar Shqipërinë në grupin e vendeve në monitorim të shtuar ose “listën Gri”⁴ dhe në kuadër të zbatimit të Planit Veprimit të ICRC/FATF⁵ (afati i zbatimit deri në Qershor 2021);

DUKE VLERËSUAR:

Prioritetet për zbatimin e rekomandimeve të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA), midis Shqipërisë dhe Bashkimit

¹ Rekomandimet e takimit 10-të Komitetit të Stabilizim-Asociimit (KSA), midis Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian mbajtur më 14 nëntor 2019 në Bruksel, ndër të cilët janë: “Shqipëria inkurajohet të intensifikojë më tej luftën kundër pastrimit të parave dhe të gjitha veprimet kundër të ardhurave nga krimi; -Në lidhje me pjesën e efektivitetit të rekomandimeve të Moneyval, Shqipëria do të ndjekë përpjekjet për të kryer hetime paralele mbi financimin e terrorizmit; ”

² Bashkëlidhur Vendimit nr. 1 datë 19.02.2020 gjendet dokumenti “Plani i veprimit”/ “Action plan”

³ Grupi i Posacëm i Veprimit Financiar (Financial Action Task Force / FATF)

⁴<http://www.fatf-gafi.org/publications/high-risk-and-other-monitored-jurisdictions/documents/increased-monitoring-february-2020.html#albania>

⁵ ICRC (International Cooperation Review Group) / Grupi i Shqyrtimit të Bashkëpunimit Ndërkombëtar, pjesë e Grupit të Posacëm të Veprimit Financiar (Financial Action Task Force/ FATF)

DUKE NËNVIZUAR:

Evropian për intensifikimin e luftës kundër pastrimit të parave dhe kryerjes së hetimeve paralele për financimin e terrorizmit; Se përbushja e rekomandimeve të KSA-së BE-Shqipëri, FATF-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF në afatet e përcaktuara nga secili institucion përgjegjës, është në interesin madhor të Shqipërisë, sa i përket bashkëpunimit ndërkombëtar dhe anëtarësimit në Bashkimin Evropian;

ME SYNIM:

Rritjen dhe forcimin e bashkëpunimit ndërinstitucional, kapaciteteve institucionale dhe profesionale, si dhe angazhimeve të secilit institucion përkatës, për përmirësimin e cilësisë, tipologjive dhe plotshmërisë të, - informacioneve nga shërbimet inteligjente, -indicieve dhe/ose provave gjatë gjurmimeve, kërkimeve dhe hetimeve nga policia gjyqësore dhe -vlerësimit nga prokuroria të provave/indicieve që provojnë rrëthanat e faktit dhe ligjt të zbatueshëm për regjistrimin e procedimit, kryerjen e hetimeve, ndjekjen penale dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq, për: -përbushjen e rekomandimeve të FATF-së dhe KSA-se, -rritjen e efektivitetit në, -hetimet që lidhen me pastrimin e parave, përfshi tipologjitet e rekomanduara, -krimeve financiare, -financimin e terrorizmit, përfshi hetimet paralele të rekomanduara, -hetimet pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e pasurive produkt i veprës penale ose i veprimtarisë kriminale, veçanërisht tipologjitet e rekomanduara (*-palët e treta të PP, -subjekte të posaçëm/profesionistë dhe nga vetë subjektet raportuese (gatekeeper), -asete që përfaqësojnë të ardhura indirekte dhe vlerë ekuivalente*), si dhe konsolidimin e praktikës së mbajtjes së track-records të posaçëm për rastet/çështjet sipas tipologjive për këto vepra penale;

NË MBËSHTETJE TË:

-Ligjt nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, nenet 14, 20, 21, 38 pika 1, pika 2 shkronjat “b”, “e”, “ë” dhe “f”, nenit 46, pikat 1, 2, 3, shkronjat “a” e “c”, 42 shkronja “a”, “l”, 43 e vijues;

- Ligjt nr. 9917 datë 19.05.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar nenit 23 e vijues i tij dhe rregullorja “Për funksionimin e Komitetit të Bashkërendimit të Luftës kundër Pastrimit të Parave”; pika 3 të nenit 4 e vijues të saj”;

-Ligjt nr.108/2014 “Për Policinë e Shtetit”, i ndryshuar, dhe pikës 3 të nenit 4 të Urdhrit nr. 204, datë 23.11.2017 të Kryeministrat “Për krijimin dhe funksionimin e Task Forcës Qendrore Ndërinstitucionale të ngarkuar me përgjegjësinë e zbatimit të Planit të Veprimit për Luftën kundër Krimit të Organizuar, operacioni “Forca e Ligjit”;

-Ligjt nr.9920/2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar;

- Ligjit nr.102, datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar;
- Kodit Penal i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligjit nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korruptionit dhe kimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar, nenet 3, 4, 5, 6, 7 e vijues të tij;
- Ligjit nr.34/2019 “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e të konfiskuara” i ndryshuar;

ME PALË NËNSHKRUESE:

Prokuroria e Përgjithshme (PP), përfaqësuar nga Prokurori i Përgjithshëm, Z.Olsian ÇELA, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

Ministria e Financave dhe Ekonomisë (MF), përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, Znj. Anila DENAJ, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

Ministria e Brendshme (MB), përfaqësuar nga Ministri i Brendshëm, Z. Sandër LLESHAJ, që këtu e më poshtë do t'i referohemi si palë,

të cilat:

bien dakord për Memorandumin e Bashkëpunimit, si më poshtë:

Neni 1

Objekti

1. Rritja dhe forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional ndërmjet Palëve, nëpërmjet masave mbikëqyrëse/monitoruese dhe koordinuese të nevojshme që angazhohen të marrin institucionet sipas kompetencave ligjore, kryerjen e analizave të përbashkëta dhe shkëmbimin e informacioneve midis institacioneve me qëllim evidentimin e saktë dhe të plotë të rrethanave të faktit në shkelje të ligjit, që përbëjnë vepër penale në fushat e pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe për kryerjen e hetimeve pasurore për sekuestrimin dhe konfiskimin e aseteve kriminale.

2. Marrja e masave nga Palët për iniciimin/realizimin e ndryshimeve ligjore apo nxjerrjen e akteve nënligjore të nevojshme, krijimin dhe/ose përmirësimin e strukturave të veçanta sipas fushës së veprimit të këtij memorandumi dhe përzgjedhjen/caktimin e personelit në këto struktura bazuar në tregues dhe kritere profesionale;

3. Institucionalizimi i bashkëpunimit paraprak për kryerjen e hetimeve proaktive dhe përdorimin e mjeteve të posaçme të hetimit, si dhe rritja e efektivitetit të bashkërendimit ndërmjet institacioneve dhe agjencive/strukturave përkatëse të zbatimit të ligjit, sipas fazave të

gjurmimit, hetimit dhe ndjekjes penale, për rritjen e cilësisë dhe plotshmërisë së: - informacioneve të inicuara nga shërbimet inteligjente, -kallëzimeve/referimeve penale dhe kryerjen e hetimeve nga strukturat perkatëse të policisë gjyqësore, -ushtrimin e ndjekjes penale, ngritjen dhe përfaqësimin e akuzës në gjyq me prova sa më të plota dhe në afate optimale, në zbatim të ligjit penal dhe procedural penal.

4. Marrja e masave nga Palët për pëmbushjen e rekomandimeve të KSA-së e FATF dhe të Planit Veprimit të ICRG/FATF në afatet e përcaktuara;

5. Informimi për çështje të tjera me interes të përbashkët të palëve në këtë Memorandumi.

6. Palët do të bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacion për realizimin e detyrave respektive, pa cënuar kompetencat ligjore respektive, mbrojtjen e të dhënave personale dhe ruajtjen e sekretit hetimor për çështje konkrete.

7. Bashkëpunimin e rregullt ndërmjet Ministrisë së Brendshme dhe Prokurorisë së Përgjithshme, në nivel qendror dhe në nivel rajonal/rrethi gjyqësor, për realizimin e analizave, vlerësimeve dhe raporte të përbashkëta në kuadër të këtij bashkëpunimi, me synim përmirësimin e politikave institucionale dhe bashkëpunimin ndërinstitucional, të cilat burojnë nga element të hetimeve të përbashkëta, në zbatim të ligjit.

Neni 2

Nivelet zbatuese, detyrat dhe takimet e përbashkëta

1. Institucionet dhe autoritetet përgjegjëse të Palëve për zbatimin e memorandumit janë:

a) Nivel qendror:

i) Prokurori i Përgjithshëm;

-Drejtori i Koordinimit Institucional;

ii) Ministri i Financave dhe Ekonomisë;

-Drejtori i Përgjithshëm i Parandalimit të Pastrimit të Parave,

-Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve,

-Drejtori i Përgjithshëm i Doganave;

iii) Ministri i Brendshëm;

-Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit).

-Drejtori për Krimet Ekonomike e Financiare në Departamentin e Policisë Kriminale;

-Kryeadministratori i Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara;

b) Në nivel vendor:

i) Drejtuesi i prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë;

ii) Drejtuesi i policisë në nivel vendor dhe/ose në komisariate të policisë;

iii) Drejtuesi i strukturave doganore përkatëse në njësinë administrative që mbulon rrethi gjyqësor i asaj prokurorie;

iv) Drejtuesi i strukturave tatimore përkatëse në njësinë administrative që mbulon rrethi gjyqësor i asaj prokurorie.

2. Në nivel qëndror do të ngrihet një strukturë e cila do të veprojë si një organ monitorues e koordinues, për të analizuar e vlerësuar ecurinë e zbatimit të masave institucionale apo ndërinstitucionale dhe/ose problematikat e evidentuara në zbatimin e tyre, si dhe për të

koordinuar zbatimin e planeve operacionale dhe ekspertizave të përbashkëta apo rekomandimeve në lidhje me ndërgjegjësimin e publikut në interes të bashkëpunimit për hetimin e veprave penale objekt i fushës së veprimit të këtij Memorandumi dhe rritjen e efikasitetit në hetimet e këtyre veprave penale në kuadrin ndërinstitucional.

3. Në nivel vendor secili institucion përcakton pikat e kontaktit me përfaqësues nga strukturat e posaçme ose përkatëse (kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, kimeve financiare dhe për hetimet pasurore) dhe/ose drejtuesit e institucioneve vendore përkatëse, për bashkëpunimin apo bashkërendimin lidhur me kërkimin dhe vlerësimin e informacioneve dhe/ose referimeve/kallëzimeve penale apo kryerjen e hetimeve proaktive, identifikimin e aseteve/pasurive produkt ose të ardhura nga veprimtaria kriminale, si dhe për kryerjen e detyrave të përbashkëta në ecurinë e hetimeve apo ndjekjes penale në çështjet komplekse dhe koordinimin/monitorimin e veprimtarive të përbashkëta sipas ligjit.

4. Institucionet zbatuese informojnë njëra-tjetrën për ndryshimet e funksionarëve të angazhuar sipas detyrave të seilës palë në kuadrin e zbatimit të këtij memorandumi, si dhe organizojnë takime e analiza të përbashkëta, sipas niveleve nëpërmjet:

i) Titullarëve të institucioneve në nivel qendror çdo 3 muaj për të diskutuar ecurinë e zbatimit të masave të këtij memorandumi, me synim vlerësimin e arritjeve dhe nevojave për rritjen e efikasitetit, duke përcaktuar drejtimet dhe masat që duhen marrë për përmbushjen e detyrave ndërinstitucionale.

ii) Strukturës së posaçme me pikat e kontaktit në nivel qendror - drejtorët e drejtive përkatëse të përcaktuar në pikën 1 shkronja "a" e këtij neni - çdo muaj dhe/ose sipas nevojave të ngutshme kur kërkohet nga secila pikë kontakti, për të shqyrtuar ecurinë e zbatimit të masave të planit veprimit, problematikat e evidentuara, planifikimin e ecurisë së masave vijuese dhe shkëmbimin e informacionit.

iii) Pikave të kontaktit në nivel vendor, çdo javë dhe/ose sipas nevojave të ngutshme kur kërkohet nga secila pikë kontakti, për të shqyrtuar ecurinë e treguesve për çështjet në ndjekje, problematikat e evidentuara, planifikimin e ecurisë së masave vijuese dhe shkëmbimin e informacionit.

Neni 3

Fusha e veprimit

1. Në kuadrin e këtij Memorandimi, Palët koordinojnë dhe monitorojnë bashkëpunimin e institucioneve dhe agjencive/strukturave të zbatimit ligjit, në gjurmimin, zbulimin, hetimin dhe ndjekjen penale në fushat e pastrimit të produkteve të veprës penale, kimeve financiare, financimit të terrorizmit, sekuestrimit dhe konfiskimit të aseteve kriminale, të kryera nga subjekte person fizik dhe/ose person juridik, sipas veprave penale:

a) Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, neni 287 i Kodit Penal;

b) Përvetësimi i parave ose mallrave që rrjedhin nga vepra penale ose veprimtarisë kriminale, neni 287/b i Kodit Penal;

c) Vepra penale në fushën e tatim - taksave, nenet 180, 181, 181/a të K.Penal;

c) Vepra penale kryera në shoqëritë tregtare nenet 164-170/ç të K.Penal;

d) Vepra penale në fushën e doganave, nenet 171-179/ç të K.Penal;

- dh) Financimi i terrorizmit, neni 230/a i Kodit Penal;
- e) Fshehja e fondeve dhe e pasurive të tjera që financojnë terrorizmin, neni 230/b i Kodit Penal;
- ë) Hetimi dhe ndjekja penale për veprat në fushat e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së, FATF-së dhe të Planit Veprimit të ICRG/FATF, synon veçanërisht në rritjen e numrit të referimeve/kallëzimeve penale dhe numrit të çështjeve për pastrim të parave sipas tipologjive të rekomanduara, -me një vepër bazë/kallëzim të huaj, -pastrimi i parave të palëve të treta nga profesionistë dhe pastrimi i parave i pavarur nga ndonjë vepër kryesore/bazë mbështetur në prova rrethanore.

2. Palët, gjithashtu, koordinojnë dhe monitorojnë bashkëpunimin dhe bashkërendimin e institucioneve dhe agjencive/strukturave përkatëse për:

a. Kryerjen e gjurmimit, verifikimit, hetimit pasuror dhe sekuestrimin e aseteve/pasurisë të subjekteve përkatëse, të referuar/kallëzuar penalisht dhe hetuar për veprat e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, bazuar në dispozitat e K.Penal dhe K.Pr.Penale.

b) Kryerjen e gjurmimit, verifikimit dhe sekuestrimin e pasurive, në kompetencë të prokurorive me juridiktion të përgjithshëm⁶ në kuadrin e hetimeve pasurore ndaj personave që përfshihen në fushën e zbatimit⁷ të ligjit nr.10192, datë 03. 12. 2009, “Për parandalimin dhe

⁶ Shih, nenet 4, 5, 6, 7 e vijues të ligjin nr.10192/2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupisonit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

⁷ Shih, po aty nenin 3 “Fusha e veprimit” në të cilin parashikohet se:

“ 1. Dispozitat e këtij ligji zbatohen për pasuritë e personave, që zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, siç përcaktohet në pikën 2, të këtij neni, mbi të cilët ekziston një dyshim i arsyeshëm, i bazuar në indicie, për:

a) pjesëmarrje dhe kryerje të krimeve nga banda e armatosur, organizata kriminale dhe grapi i strukturuar kriminal, të parashikuara nga kreu XI i Kodit Penal;

b) pjesëmarrje dhe kryerje e krimeve nga organizata terroriste dhe krimeve për qëllime terroriste, parashikuar nga kreu VII i Kodit Penal;

c) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 109, 109/b, 110/a, 128/b, 278/a, 282/a, 283, 283/a dhe 284/a të Kodit Penal;

ç) pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal;

d) kryerjen e krimeve të parashikuara në nenet 164/a, 164/b, 183, 244, 244/a, 245, 245/1, 256, 257, 257/a, 258, 259, 259/a, 260, 312, 319, 319/a, 319/b, 319/c, 319/ç, 319/d, 319/dh dhe 319/e të Kodit Penal, në rastet kur ekzistojnë indicie për përfitim pasuror të paligjshëm.

2. Dispozitat e këtij ligji zbatohen edhe ndaj pasurive të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në pronësi ose të zotëruara në mënyrë të tërthortë nga:

a) personat e afërm (bashkëshorti, fëmijët, të paralindurit, të paslindurit, vëllezërit, motrat, bashkëjetuesi), për të cilët prezumohet regjistrimi i rremë, përvçese kur provohet e kundërtë;

b) personat fizikë ose juridikë, për të cilët ka të dhëna të mjaftueshme se pasuritë ose veprimtaritë e tyre zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, ose janë përdorur, kanë lehtësuar apo kanë ndikuar në një formë të caktuar në kryerjen e veprimtarive të jashtëligjshme prej tyre.

3. Prezumimi i regjistrimit të rremë të pasurive dhe veprimtarive ekonomike të personave të përmendur në pikën 1, të këtij neni, në emër të personave të afërm, të përmendur në shkronjën “a”, të pikës 2, të këtij neni, zbatohet kur ka të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

4. Të dhënat e mjaftueshme që pasuritë ose veprimtaritë e personit fizik ose juridik të përmendur në shkronjën “b”, të pikës 2, të këtij neni, zotërohen, pjesërisht ose plotësisht, në mënyrë të tërthortë, nga personat e përmendur në pikën 1, të këtij neni, nxirren nga marrëdhënia ndërmjet personit fizik dhe juridik me personat e parashikuar në pikën 1, të këtij neni, dhe nga të dhëna të dobishme, të siguruara në rrugë të ligjshme, të cilat krijojnë dyshimin e arsyeshëm për paligjshmérinë e origjinës së pasurisë.

5. Masat parandaluese mund të kërkoohen dhe ndaj trashëgimtarëve të personit, subjekt i zbatimit të këtij ligji, por, në çdo rast, jo më vonë se 5 vjet nga data e vdekjes.

6. Ky ligj zbatohet edhe për pasuritë e personave, të vëna përpara hyrjes në fuqi të tij, me kusht që të ekzistojnë

goditjen e krimtit të organizuar, trafikimit dhe korrupcionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

c) Kryerjen e hetimeve pasurore në zbatim të rekomandimeve të FATF dhe të Planit Veprimit të ICRG/FATF, me synim rritjen sekuestrimeve/konfiskimeve të aseteve dhe pasurive produkt i veprës penale penale ose i veprimtarisë kriminale, veçanërisht sipas tipologjive të rekomanduara, nga -palët e treta të pastrimit të parave, -subjekte të posaçëm/profesionistë, nga -vetë subjektet raportuese (gatekeeper), si dhe i aseteve që përfaqësojnë të -ardhura indirekte dhe/ose -vlerë ekuivalente.

Neni 4

Kontributi i Prokurorisë (PP)

1. Prokuroria e Përgjithshme do të nxjerrë një udhëzim të përgjithshëm “Për masat administrative dhe proceduriale për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit parave, kimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm” për të normuar ndërmjet të tjera:

a) Mënyrën e riorganizimit të seksioneve të posaçme kundër pastrimit të parave, kimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimeve pasurore në prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë Tiranë, Durrës, Shkodër, Elbasan, Fier, Vlorë, Korçë, si dhe përcaktimin e prokurorëve që do të ndjekin rastet/çështjet në këtë fushë në prokuroritë ku nuk do të ketë seksione të posaçme;

b) Përcaktimin e kritereve profesionale për përzgjedhjen/caktimin nga drejtuesit e prokurorive përkatëse të prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore në seksionin e posaçëm lidhur me këto vepra penale si:

- të kenë eksperiencë në punë jo me pak se katër vjet;
- të kenë marrë pjesë në kurse trajnimi specifike për këto vepra penale;
- të kenë eksperiencia dhe rezultate në çështje konkrete:

- në kryerjen e hetimeve për oficerët e policisë gjyqësore, dhe;
- në ushtrimin e ndjekjes penale dhe përfaqësimin e akuzës/çështjeve në gjykatë për prokurorët;

c) Përcaktimin e kompetencës lëndore të këtyre seksioneve të posaçme për veprat penale dhe subjektet sipas parashikimeve në Kodin Penal, Kodin e Procedurës Penale, ligjin nr.10192/2009, etj dhe nenin 3 të këtij Memorandimi.

ç) Përcaktimi i marrëdhënieve të prokurorëve me oficerët e policisë gjyqësore, të seksionit të posaçëm në prokuroritë e juridiksionit të përgjithshëm dhe të shërbimeve në strukturat hetimore përkatëset në policinë e shtetit, dogana e tatime, për koordinimin e punës ndërmjet tyre, gjatë kryerjes së hetimeve dhe ushtrimit të ndjekjes penale për kallëzimit/referimet e dërguara nga strukturat hetimore të shërbimeve përkatëse, pa cënuar pavarësinë e prokurorëve në ushtrimin e funksioneve sipas ligjit.

2. Drejtuesi i prokurorisë përkatëse, brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i këtij Memorandumi, cakton prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore në seksionin e posaçëm të riorganizuar dhe

drejtuesin e seksionit, si dhe u siguron shërbime administrative mbështetëse të posaçme për veprimtarinë normale të tyre.

3. Në prokuroritë me juridiktion të përgjithshëm ku janë riorganizuar seksionet e posaçme pikë kontakti është shefi i seksionit të posaçëm, ndërsa në prokuroritë ku nuk ka seksione të posaçme pikë kontakti është drejtuesi i prokurorisë përkatëse, ose zëvendës drejtuesi i autorizuar prej tij. Pika e kontaktit, brenda datës 10 të çdo muaji dhe/ose në çdo kohë kur kërkohet, raporton të dhënat statistikore sipas formularit të miratuar tek pika e kontaktit/koordinatori në Prokurorinë e Përgjithshme.

4. Prokurorët e seksionit të posaçëm bashkëpunojnë dhe shkëmbejnë informacione me institucionet e përfshira, në këtë Memorandum, dhe jo vetëm, në të gjitha fazat e hetimeve paraprake, për iniciimin dhe kryerjen e hetimeve proaktive, kryerjen e analizave dhe vlerësimëve të përbashkëta për kërkimin, gjetjen dhe administrimin e provave gjatë veprimtarisë hetimore, në zbatim të rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF.

5. Prokuroria e Përgjithshme në bashkëpunim me misionet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale, do të ofrojnë asistencë në disa drejtime, ku përfshihet dhe:

a) Përditësimi i Manualit të Projektit të Binjakëzimit të BE “*Mbështetje për strukturat e luftës kundër pastrimit të parave dhe strukturat e hetimit të krimeve financiare në Shqipëri*” me standartet dhe praktikat e mira evropiane, praktikën shqiptare dhe ide novative mbi metodikën e hetimeve të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

6. Prokuroria e Përgjithshme në kuadrin e këtij memorandumi angazhohet për bashkëpunimin dhe koordinimin edhe në fusha veprimi të tjera të veprimtarisë ndërinstitucionale me Ministrinë e Brendshme dhe institucionet e përfshira (Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit dhe Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara), me synim rritjen e eficënsës në kryerjen e hetimeve dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale.

Neni 5

Kontributi i Ministrisë së Brendshme dhe institucioneve të saj

1. Ministria e Brendshme (MB), Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit (DPPSH) dhe Agjencia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara dhe Konfiskuara (AAPS) sigurojnë që struktura hetimore përkatëse që ka ndjekur një hetim të veçantë, kur autorizohet/delegohet nga prokurori të vazhdojnë hetimin, ushtron funksionet sipas ligjit dhe ndihmon me mjetet logistike përkatëse në kërkimin, sigurimin dhe administrimin e provave deri në përfundim të gjykimit të çështjes, në funksion dhe të sigurisë fizike të prokurorit në seancat gjyqësore dhe jashtë saj.

2. Nxjerrjen e një akt nënligjor (urdhër/udhëzim) “Për masat administrative, për rritjen e efektivitetit në luftën kundër pastrimit parave, krimeve financiare, financimit të terrorizmit dhe sekuestrimin e aseteve kriminale, në strukturat e posaçme të shërbimeve të policisë gjyqësore në polisinë e shtetit” për të normuar punën në zbatim të këtij Memorandumi, brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i tij.

3. Nxjerrjen e një akt nënligjor (urdhër/udhëzim) “Për administrimin e pasurive të sekuestruara e konfiskuara”, brenda 15 ditëve nga nënshkrimi i këtij Memorandumi, për të normuar mbajtjen e të dhënave të unifikuara në nivel kombëtar për pasuritë e sekuestruara,

konfiskuara e rikuperuara, për të normuar punën, rritur cilësinë e menaxhimit, ruajtur dhe rritur me sa është e mundur vlerën e aseteve të sekuestruara e konfiskuara.

4. Mbështetjen me burime të mjaftueshme njerëzore, financiare dhe teknike në strukturat hetimore të posaçme të shërbimeve të policisë gjyqësore në njësitë administrative vendore ku ushtrojnë veprimtarinë prokuroritë pranë gjykatave të shkallës së parë me juridikSION të përgjithshëm.

5. Për zgjedhjen/caktimin e oficerëve të policisë gjyqësore të shërbimeve pranë strukturave hetimore përkatëse bazuar në kriterje profesionale: -të kenë eksperiencë në punë jo më pak se 4 vjet; -të kenë marrë pjesë në trajnime specifike për veprat penale objekt i këtij Memorandumi; -të kenë eksperiencia dhe rezultate në çështje konkrete në kryerjen e hetimeve për këto vepra, angazhimin e oficerëve të policisë gjyqësore në dispozicion vetëm të kësaj strukture dhe palëvizshmërinë e tyre përveç se me marrëveshje paraprake të palëve.

6. Rritjen e cilësisë dhe plotëshmërisë së informacioneve, gjurmimeve, referimive dhe/ose kallëzimive penale në prokurori për veprat penale objekt i këtij Memorandumi nga oficerët e policisë gjyqësore të shërbimeve në strukturën hetimore përkatëse.

7. Koordinimin e veprimtarisë së strukturës hetimore përkatëse të shërbimeve të policisë gjyqësore me ato të strukturës përkatëse në prokurori në kuadër të strukturave të përbashkëta koordinuese që do të ndërtohen në nivel vendor:

a) në fazën para referimit përmes një konsultimi e vlerësimi paraprak të materialeve objekt referimi apo kallëzimi penal, dhe;

b) në fazën e hetimeve paraprake për vlerësimin e informacioneve apo indicieve dhe administrimin e provave për ushtrimin e ndjekjes penale;

c) duke synuar kryerjen e hetimeve proaktive, rritjen e cilësisë së referimeve dhe hetimeve, për zbulimin e veprimtarisë kriminale të subjekteve të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale, sigurimin e provave dhe sekuestrimin e aseteve kriminale, veçanarisht ato me fokus tipologjitet e rekomanduara, nga -palët e treta të pastrimit të parave me subjekte të posaçëm/profesionistë, nga -vetë subjektet raportuese (gatekeeper), si dhe i asetet që përfaqësojnë të -ardhura indirekte nga veprimtaria kriminale dhe/ose -me vlerë ekuivalente me të ardhurat nga veprimtaria kriminale.

8. Shërbimet e policisë gjyqësore në strukturat e posaçme vendore e qëndrore bashkëpunojnë, shkëmbejnë informacione dhe kryejnë analiza të përbashkëta me institucionet e përfshira në këtë Memorandum, dhe jo vetëm, në të gjitha fazat e hetimeve paraprake, përzbatim e rekomandimeve të KSA-së e FATF-së dhe Planit të Veprimit të ICRG/FATF.

9. Ministria e Brendshme dhe institucionet e përfshira (Drejtoria e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Agjensia e Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara) në kuadrin e këtij memorandumi angazhohen për bashkëpunimin dhe koordinimin edhe në fusha veprimi të tjera të veprimtarisë ndërinstitucionale me Prokurorinë e Përgjithshme, me synim rritjen e eficënsës në kryerjen e hetimeve dhe rritjen e efektivitetit në parandalimin dhe goditjen e veprimtarisë kriminale.

Neni 6

Kontributi i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit Pastrimit të Parave (DPPP)

Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave në kuadër të këtij Memorandumi, angazhohet të:

1. Administroj informacione të inicuara nga shërbime inteligjente, sa më plota dhe të verifikuara me të dhëna apo indicie për vepra penale pastrimi i parave, krimet financiare dhe financimi i terrorizmit, të kryera brenda ose jashtë vendit, të cilët dërgohen për vlerësim në strukturat hetimore përkatëse në policinë e shtetit dhe/ose në seksionet e posaçme në prokurori, me synim inicimin e hetimeve proaktive dhe/ose kryerjen e veprimeve hetimore për administrimin e provave të nevojshme dhe/ose sekuestrimin e aseteve të veprimarisë kriminale;

2. Mbledhë dhe administroj raportimet javore/periodike të përcjella nga PP, DPPSH, si dhe çdo të dhënë/dokument tjetër në funksion të tyre.

3. Marrë masa, për të bashkërenduar, kryerjen e analizave të përbashkëta dhe koordinuar me strukturat përkatëse hetimore në shërbimet e polisë gjyqësore në Policinë e Shtetit, Dogana, Prokurori dhe/ose institucionet tjetra të përfshira lidhur me ecurinë e rasteve/çështjeve bazuar në referimet/informacionet e inicuara dhe/ose plotësuara nga ana e saj;

4. Ofroj çdo asistencë tjetër të nevojshme të kërkuar nga Palët në kuadër të këtij Memorandumi.

Neni 7

Kontributi i Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (DPT)

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve angazhohet për marrjen e masave të nevojshme, për:

1. Caktimin e personave, që do ta angazhohen ekskluzivisht në verifikimin/hetimin e rasteve apo veprave përkatëse, bazuar në kritere profesionale, - të kenë integritet të lartë moral dhe profesional të verifikuar, -të janë trajnuar për veprat penale përkatëse objekt i këtij Memorandumi dhe -të kenë eksperiencia dhe rezultate në raste konkrete për këto vepra.

2. Sigurimin e shkëmbimit në kohë të informacionit, kryerjen e analizave të përbashkëta dhe koordinimin e veprimtarisë së strukturës përkatëse në tatime me ato të strukturës përkatëse në prokurori në kuadër të strukturave të përbashkëta koordinuese që do të ndërtohen në nivel vendor:

a) Për të rritur cilësinë e referimeve dhe/ose kallëzimeve penale përmes një procesi të koordinimit dhe konsultimit paraprak, me strukturën përkatëse në prokurori ose në policinë e shtetit, për të vlerësuar elementët e veprave penale që përpara nisjes së referimit/kallëzimit penal në prokurori, dhe;

b) Për të vijuar dërgimin e informacioneve dhe/ose dokumentave plotësuese me rrethanat e reja dhe/ose provat që janë evidentuar pas referimit apo kallëzimit penal në prokurori, edhe gjatë fazës së hetimeve paraprake apo ushtrimit të ndjekjes penale.

3 Ndjekjen në rrugë administrative të të gjitha rasteve kur nga hetimet rezultojnë elementë të shkeljeve administrative të parashikuara në Kodin Tatimor, edhe në rastet kur nga hetimet nuk rezultojnë elementët e veprës penale.

Neni 8

Kontributi i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave (DPD)

Drejtoria e Përgjithshme e Doganave angazhohet për marrjen e masave të nevojshme, për:

1. Caktimin e personave në strukturën hetimore përkatëse, që do të angazhohen për hetimin e veprave penale në fushën e veprimit të këtij Memorandimit, bazuar në kritere profesionale si, - të kenë integritet të lartë moral dhe profesional të verifikuar, -të jenë trajnuar për veprat penale përkatëse, dhe -të kënë eksperienca dhe rezultate në hetimin e rasteve/çshtjeve konkrete për këto vepra penal.

2. Sigurimin e shkëmbimit në kohë të informacionit, kryerjen e analizave të përbashkëta dhe koordinimin e veprimtarisë së strukturës hetimore doganore përkatëse me ato të strukturës përkatëse në prokurori në kuadër të strukturave të përbashkëta koordinuese që do të ndërtohen në nivel vendor:

-në fazën para referimit përmes një konsultimi e vlerësimi paraprak të materialeve objekt referimi apo kallëzimi penal, dhe;

-në fazën e hetimeve paraprake për vlerësimin e informacioneve apo indicieve dhe administrimin e provave për ushtrimin e ndjekjes penale;

-me qëllim kryerjen e hetimeve proaktive, rritjen e cilësisë së referimeve/kallëzimeve dhe hetimeve, për zbulimin e veprimtarisë kriminale të subjekteve të përfshirë në kryerjen e këtyre veprave penale, sigurimin e provave dhe sekuestrimin e aseteve kriminale, veçanarisht ato me fokus tipologjitet e rekondituara, nga -palët e treta të pastrimit të parave me subjekte të posaçëm/profesionistë, nga -vetë subjektet raportuese (gatekeeper), si dhe i aseteve që përfaqësojnë të -ardhura indirekte nga veprimtaria kriminale dhe/ose -me vlerë ekvivalentë me të ardhurat nga veprimtaria kriminale.

3 Ndjekjen në rrugë administrative të të gjitha rasteve kur nga hetimet rezultojnë elementë të shkeljeve administrative të parashikuara në Kodin Doganor, edhe në rastet kur nga hetimet nuk rezultojnë elementët e veprës penale.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit dhe trajnimet

1. Palët krahas takimeve të përbashkëta të parashikuara në nenin 2 të këtij Memorandimi, komunikojnë dhe lidhen me njëra-tjetrën për efekt bashkëpunimi edhe me shkrim, në rrugë elektronike dhe çdo lloj forme tjeter të përshtatshme komunikimi e cila më pas zyrtarizohet për çështjet më të rëndësishme.

2. Informacioni i shkëmbyer mes Palëve administrohet sipas rregullave të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale; ligji nr.8457, datë 11.2.1999 "Për informacionin e klasifikuar sekret shtetëror" i ndryshuar; ligjin nr.9367, datë 7.4.2005 "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike" i ndryshuar, dhe ligjin nr. 9887, datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.

3. Palët në bashkëpunim me misionet ndërkombëtare që asistojnë sistemin e drejtësisë penale organizojnë aktivitete të përbashkëta trajnuese të prokurorëve, oficerëve të policisë gjyqësore në prokurori, policinë e shtetit, dogana, tatime, dhe jo vetëm, të përfshirë në strukturat përkatëse në kuadrin e këtij Memorandumi, me tema lidhur me analizën e riskut, gjurmimin, verifikimin, hetimin, ndjekjen penale dhe gjykimin e veprave penale të pastrimit të parave, krimet financiare, financimit të terrorizmit dhe hetimet pasurore, me synim forcimin e kapaciteteve profesionale.

Neni 10

Dispozita të fundit

1. Ky Memorandum do të hyjë në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët dhe do të mbetet në fuqi për një periudhë të pacaktuar.
2. Amendamentet mund të bëhen me marrëveshje ndërmjet Palëve nëpërmjet shkëmbimit të komunikimit me shkrim, duke saktësuar datën e hyrjes në fuqi.
3. Megjithë sa është parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, ky Memorandum mund të përfundojë në çdo kohë nga secila palë, duke njoftuar paraprakisht, me shkrim palët.
4. Memorandumi hartohet në gjuhën shqipe, përgatitet dhe nënshkruhet në 16 kopje origjinale, dy prej të cilave depozitohen në secilin Palë të pëfshirë të këtij Memorandumi.

Ky Memorandum u nënshkrua sot, më datën ___/___/2020.

PROKURORI I PËRGJITHSHËM

OLSIAN ÇELA



MINISTRI I BRENDSHËM

SANDËR LLESHAJ



MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ



KUNDËRFIRMOJNË

PËRFAQËSUESIT E PALËVE TË PËRFSHIRË:

DREJTORI PËRGJITHSHËM
I POLICISË SHTETIT

ARDI VELIU

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I DOGANAVE

GJON BARDHI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM I PARANDALIMIT
TË PASTRIMIT TË PARAVE

ELVIS KOÇI

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
I TATIMEVE

DELINA IBRAHIMAJ

KRYEADMINISTRATORI I AAPSKE

ARTUR KALA